

Komunikatë për medie Komuniteti i çiklistëve të Prizrenit pedalon për kors

Në performansën publike “Vozit Biçikletë” të organizuar nga EC Ma Ndryshe, në kuadër të projektit “Qyteti gjithëpërfshirës...”, të financuar nga Olof Palme International Center (OPIC), e cila përkrahet nga Qeveria e Suedisë, të shtunën kanë marrë pjesë dhjetëra çiklistë, të cilët me pedalimin nëpër qytet kanë adresuar në mënyrë publike kërkesën për planifikimin e korsive (shtigjeve) për biçikleta në qytetin e Prizrenit.

Grumbullimi i çiklistëve ka nisur në sheshin përballë Xhamisë së Sinan Pashës, me ç’rast nga Ura e Arastës ka nisur edhe xhiroja që ka përshkruar rrugën unazore të qytetit. Policia e Kosovës ka asistuar në këtë aktivitet komunitetin e çiklistëve, që është përbërë nga grupmoshat e ndryshme. Pas xhiros së plotë nëpër rrugën unazore të qytetit, çiklistët janë kthyer në Kej, ku edhe kanë nënshkruar peticionin për planifikimin e korsive (shtigjeve) për biçikleta.

“Qyteti gjithëpërfshirës...” është projekt tre-vjeçar i EC Ma Ndryshe, i cili synon të artikulojë nevojat e grupeve të komunitetit dhe t’i përkthejë ato në plane të zbatueshme urbane të komunës së Prizrenit. Grupet e komunitetit me të cilat punohet në këtë projekt janë të shpërndarë në lagje të ndryshme të qytetit dhe paralelisht zhvillohet edhe procesi i avokimit dhe bashkëpunimit me komunën e Prizrenit dhe Drejtorinë e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor për të siguruar përfshirjen e kërkesave të qytetarëve në planifikimin urban të qytetit.

Kërkesa për planifikimin e korsive (shtigjeve) për biçikleta në qytetin e Prizrenit ka ardhur nga komuniteti.

Me respekt,
Fisnik Minci, koordinator projekti
OJQ EC Ma Ndryshe
Saraçët 5, 20000 Prizren
Bulevardi Nëna Terezë 30B H-I-5, 10000 Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
[+381 38 224 967](tel:+38138224967) & [+381 29 222 771](tel:+38129222771)
[+377 44 289 132](tel:+37744289132)
fnisnik.minci@ecmandryshe.org

Projekti "Qyteti gjithëpërfshirës – planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren" përkrahet financiarisht nga Olof Palme International Center, që përkrahet nga Qeveria e Suedisë

